

Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Më 17 janar, Kryetarja e DHSK-së, Trendafilova caktoi Panelin e Gjykatës Supreme për të marrë vendim në lidhje me kërkesën e dorëzuar nga Mbrojtja e Salih Mustafës, që kërkon zgjatjen e afatit për dorëzim të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë. Gjykatësit Ekaterina Trendafilova (kryegjykatëse), Kristinë Van den Vajngart, dhe Daniel Fransen janë caktuar anëtarë të Panelit.

Më 25 janar, Paneli i Gjykatës Supreme nxori dy vendime lidhur me kërkesën e mundshme për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Në vendimin e parë, Paneli përcaktoi se znj. Venkateswari Alagendra nuk e kishte njoftuar Trupin Gjykses II (në të cilin është i akuzuar Jakup Krasniqi dhe të cilin ajo gjithashtu e përfaqëson) lidhur me synimin e saj që të përfaqësojë z. Mustafa, siç kërkohet me Kodin e Etikës në mënyrë që të pranonte vendimin e Trupit Gjykses nëse ekziston ndonjë konflikt interesi. Rrjedhimisht, Paneli deklaroi se emërimi i Alagendra si avokate e re e Mustafës nuk ka efekt juridik dhe urdhëroi Administratoren që të caktojë mbrojtësin kujdestar për të përfaqësuar Mustafën derisa të zgjidhet çështja.

Në vendimin e dytë, Paneli i Gjykatës Supreme hodhi poshtë kërkesën e Mbrojtjes së Mustafës lidhur me zgjatjen e afatit për të dorëzuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe vuri në dukje se afatet kohore të parashikuara në Ligj lidhur me kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të ndryshohen me Rregulloren e Punës dhe të Provave dhe se znj. Alagendra nuk ka legjitimet për ta dorëzuar kërkesën.

Këtë javë, në gjykimin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, seancat u mbajtën të martën, të mërkurën dhe të enjten. Dëshmitari i 41-të i thirrur nga Prokuroria vazhdoi dhënien e dëshmisë të martën. Sipas Prokurorisë, dëshmitari është i afërm i familjes së një viktime të vrasjes së paligjshme dhe zhdukjes me forcë nga Drenoci. Dëshmitari po dëshmon me masa mbrojtëse dhe kryesisht në seancë private.

Gjatë seancës së sotme, dëshmitari i 39-të i Prokurorisë z. Dejan Jeftiq, vazhdoi dëshminë e tij, e cila filloi më 11 dhjetor 2023. Sipas përmbledhjes së shkurtër të lexuar nga Prokuroria në dhjetor, dëshmitari u arrestua nga shqiptarë të armatosur në korrik të vitit 1998, disa prej të cilëve kishin uniforma të zeza dhe më pas u çua në Budakovë.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 22 janar, Trupi Gjykses konstatoi se pjesë të caktuara të dëshmisë së dëshmitarit që dha dëshmi në tetor 2023 mund të riklasifikohen si publike dhe gjykatësit udhëzuan Prokurorinë që t'i dorëzojë Zyrës Administrative versionin e ri, me më pak redaktime, të transkriptit përkatës.

Kjo është rrjedhojë e urdhrit gojor të Trupit Gjykses, të lëshuar në nëntor, në të cilin u përcaktua procedura për rishikimin e transkripteve të seancave private, me qëllim që më shumë prej tyre të bëhen publike, duke vazhduar njëkohësisht garantimin e mbrojtjes së dëshmitarëve.



Në çështjen gjyqësore të Pjetër Shalës, më 19 janar, Trupi Gjykses urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të z. Shala, duke konstatuar se vazhdon të ekzistojë rreziku që ai mund të pengojë procesin dhe të kryejë krime të tjera kundër dëshmitarëve që kanë dhënë dëshmi në këtë çështje gjyqësore dhe/ose janë paraqitur në gjykatë. Trupi Gjykses vazhdon të jetë i mendimit se këto rreziqe mund të zvogëlohen mjaftueshëm vetëm me anë të kornizës për monitorimin e komunikimeve që përdoret në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje

